

PAGESA E PLOTE



A e dini? Ju jeni borxhli për shkak të mëkatit tuaj.

“Sepse të gjithë kanë mëkatuar dhe e kanë humbur lavdinë e Perëndisë.” (Romakët 3:23) “Tani e dimë rregullin: ajo që është shkruar në Ligjin e Perëndisë vlen për ata, të cilëve u drejtohet Ligji. Askush s’mund të justifikohet. Mbarë njerëzimi është fajtor para Perëndisë.” (Romakët 3:19)

A e dini? Se sa do tju kushtojë borxhi i mëkatit dhe se çdo të sjellë ai në përjetësi?

“Sepse pagesa e mëkatit është vdekja.” (Romakët 6:23a) “Vdekja dhe ferri u hodhën në liqenin e zjarrtë. Kjo është vdekja e dytë.” (Zbulesa 20:14) “Dhe tymi i tmerrit të tyre u ngrit përgjithnjë.” (Zbulesa 14:11a)

A keni dëgjuar?

Se mëkati juaj është paguar plotësisht.

“Dhe ajo do të lindë një djalë. Ai do të quhet Jezus: sepse Ai do të shpëtojë njerëzit nga mëkatet e tyre.” (Mateu 1:21) “Sepse Krishti ka vuajtur një herë për mëkatet, ka vuajtur i drejti për të padrejtin, për të na shpënë ne tek Perëndia.” (1 Pjetri 3:18a) “Kur i dhanë Jezusit uthull Ai tha: ‘Mori fund,’ dhe pastaj uli kokën e dha shpirt.” (Gjoni 19:30)

A do të besoni? Biblën, të shkruarën që ka lënë Perëndia për ju.

“Kjo është një thënie besimplotë dhe plotësisht e pranueshme, se Krishti, Jezusi erdhi në këtë botë për të shpëtuar mëkatarët.” (1 Timoteu 1:15a) “Ky është shkrimi; Perëndia na ka dhënë ne jetën e përjetëshme dhe kjo jetë është dhënë nëpërmjet Birit të

tij.” (1 Gjoni 5:11) “Sepse Shkrimi i Shenjtë thotë se kushdo që i beson atij nuk do të turpërohet.” (Romakët 10:11)

A do ta besoni? Përjetësinë e shpirtit tuaj plotësisht tek Jezus Krishti.

“Sepse Perëndia e deshi kaq shumë botën sa dha Birin e tij të vetëm që kushdo që beson në të, të mos vdesë, por të ketë jetën e përjetëshme.” (Gjoni 3:16) “Dhe nëpërmjet tij, të gjithë ata që besojnë janë të justifikuar nga çdo gjë, ku më parë nuk mund t'i justifikonte dot ligji i Moisiut.” (Veprat 13:39) “Besoni në Zotin, Jezus Krishtin dhe ju do të shpëtoheni.” (Veprat 16:31b)

Kujtoni: Ju duhet të besoni Jezus Krishtin dhe asgjë tjetër.

“Para Perëndisë është krejt ndryshe: kush pranon se s'ka asnjë punë (merituese) për të treguar, por i beson Atij që i amnistion plotësisht fajtorët, del i pafajshëm me anë të pranimit të amnistisë.” (Romakët 4:5) “Jezusi iu përgjigj dhe u tha: ‘Kjo është punë e Perëndisë që ju të besoni në atë që ai ka dërguar.’” (Gjoni 6:29) “Prandaj ne po përfundojmë se njeriu është i justifikuar nëpërmjet besimit dhe nëpërmjet veprave që ai kryen sipas Ligjit.” (Romakët 3:28)

A keni kërkuar

“PAGESA E PLOTE”

**Faturën për borxhin
e mëkatit?**

Unë zgjedh ti besoj Jezus Krishtit dhe pagimit të tij të plotë për borxhin e mëkatit tim. *“Të gjithë profetët dëshmojnë për të, se nëpërmjet emrit të tij kushdo që beson do të marrë faljen për mëkatet që ka bërë.”* (Veprat 10:43) *“Njeriu i besoi me zemër drejtësisë dhe me gojë rrëfeu drejt shpëtimit.”* (Romakët 10:10) *“Sepse kushdo që do të thërrasë në emër të Zotit do të shpëtohet.”* (Romakët 10:13)

Unë zgjedh të hedh poshtë pagesën që ka bërë Jezus Krishti dhe vendos besimin në vetëpagesën time. *“E si mund të shpëtojmë, nëqoftëse ne neglizhojmë kaq shumë shpëtimin.”* (Hebrenjtë 2:3a) *“Do të vijë ti dënojë me flakë ata që nuk duan t’ia dinë për Perëndinë dhe që nuk duan të dëgjojnë për lajmin e mirë, për Jezusin, Zotin tonë. Për dënim ata do të ndahen përgjithmonë nga Zoti. nga pushteti dhe madhështia e tij.”* (2 Selanikasve 1:8 dhe 9)

Ju lutemi na dërgoni këtë fletushkë për të na treguar se pasi e lexuat atë, ju keni vendosur të besoni në Jezus Krishtin, si në Shpëtimtarin tuaj

Emri _____
Adresa _____
Qyteti _____
Shteti _____ Mosha _____



FELLOWSHIP TRACT LEAGUE

P.O. BOX 164 • LEBANON, OH 45036

www.fellowshiptractleague.org © Tract 2830 (Albanian)

All tracts free as the Lord provides. Not to be sold.